



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË  
SKUPËSTINA OPSTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



**KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË**

Nr. Protokollit	04/ 2024
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	21.08.2024

**PROCESVERBAL**

**Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).**

Takimi filloi në ora 10.00

**Në takim morën pjesë :**

**Afrim Sylaj** - Komandant në Stacionin Policor në Therandë  
**Haki Haxhi** - përfaqësues i Komunitetit Islam  
**Albert Demaj** - përfaqësues i Komunitetit Katolik  
**Enver Shabani** - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë  
**Qaush Hajdari** - përfaqësues e EVSB-së  
**Remzi Bajselmani** - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit  
**Habibe Bytyqi** - Zyrtare për Barazi Gjinore  
**Albestrim Rexhepi** - përfaqësues i FSK-së  
**Drilon Zyba** - përfaqësues i KLSP-së  
**Adem Derguti** - Kryetar i KPAK-së  
**Rozeta Jahaj** - përfaqësuese e OJQ-ve  
**Refki Zogaj** - përfaqësues i komunitetit të biznesit  
**Eurolinda Zenelaj** - përfaqësuese e medieve lokale  
**Xheladin Sadikaj** - përfaqësues i zyrës KKK-së  
**Qëndresa Baftjaraj** - përfaqësuese e KPAK-së  
**Myrvete Shala** - përfaqësuese e Shqiptarëve  
**Denis Sofra** - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li  
**Zekë Berisha** - përfaqësues i Romëve  
**Nazim Shabanaj** - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj i cili i njoftoi me rendin e ditës.

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;**
- 3. Informatë dhe analizë nga policia e Suharekës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme;**
- 4. KKSB-ja t'i ofroj bashkëpunim dhe ta mbështes Këshillin e shkollave dhe nxënësve për të vepruar të organizuar për parandalimin dhe eliminimin e dukurive negative;**

**Kryetari** - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

### **Aprovohet rendi i ditës**

#### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryetari** - e hedh në votim pikën 1.

### **Aprovohet pika 1**

#### **Pika 2. Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;**

**Kryetari** - ia jep fjalën Drejtorit të DKA-së.

**Remzi Bajselmani** - përshëndet të pranishmit. Përgatitjet për fillimin e vitit shkollor kanë fillu prej fillimit të korrikut. Dy vitet e fundit qershori po merr shumë i nxehtë dhe edhe këtë vit ka qenë kalendari në diskutim mirëpo ministria ka vendos që kalendari përafërsisht të jetë i njëjtë. Kemi fillu disa renovime në 5 shkolla dhe me pjesën e stafit jemi koordinuar dhe besoj që si komunë e Suharekës jemi të përgatitur për fillimin e procesit mësimor në të gjitha institucionet e komunës tonë. Po ashtu edhe çështja e sigurisë ka qenë shumë e mirë dhe prap vazhdon të jetë e mirë prej kohës kur janë vendos kamerat nëpër shkolla dhe bashkëpunimi me policinë ka arrit që kjo çështje të jetë mjaft e sigurt.

**Habibe Bytyqi** - e dimë që subvencionohen librat dhe prindërit obligohen që vet ti blejnë librat. Drejtor, bazuar në vitin e kaluar që ka pas vështirësi ku vetëm një librari ka pas shitje, si do të jetë këtë vit? A do të jetë vetëm një librari dhe do të krijohen tollovi dhe pritje për prindërit apo ka edhe librari tjera që ka me bo shitjen?

**Remzi Bajselmani** - këtë pjesë edhe vitin e kaluar e kemi ngrit si shqetësim por prap ministria ka vendos ti subvencionojë prindërit dhe nuk është në kompetencën tonë. Ka fillu subvencionimi i prindërve me mjete por ne nuk kemi informacion se cila librari kontraktton shtëpitë botuese.

**Avni Bytyqi** - dua të ju informoj që unë dje isha në librarinë “Edori” dhe ajo më tha që këtë vit ka mundësi që ne fare mos m’u marrë me këtë çështje. Ndoshta është mirë me i thirrë përfaqësuesit e librarive, me diskutuar dhe ndoshta ata kanë mundësi m’u inkuadrua edhe ata në këtë proces dhe me ia lehtësu prindërve të komunës tonë për arsye se nëse libraritë tona nuk furnizohen me tekste, ka me qenë e vështirë me shkuar në Prizren m’u furnizua.

**Remzi Bajselmani** - me vend është ky reagim dhe është shumë shqetësuese. Vitin e kaluar disa shkolla e kanë kryer punën mirë. Disa shkolla më të mëdha janë grumbull dhe kanë shku në librarinë” Altera” në Prizren dhe kanë porosit të gjithë cikli dhe i kanë dërgua në shkollë.

**Adem Dërguti** - organizimi me tekste shkollore aspak nuk më pëlqen. Më herët ka qenë më mirë ngase Ministria i shpërndante librat. Ndoshta një prind i ka 3-4 nxënës dhe i merr ai paret, i shpenzon për shkak

të gjendjes ekonomike jo të mirë dhe nuk ia blen fëmijëve librat. Ka me pas këso raste dhe mendoj që ka me pas probleme edhe këtë vit.

**Remzi Bajselamni** - ne e kemi ngrit zanin që është keq kjo formë. Më e mira ka qenë forma kur librarit i kanë sjell librat në shkollë dhe nuk mund të keqpërdoren sepse çdo shkollë raporton numrin e nxënësve në sistemin Smia dhe ministria e ka numrin e saktë të nxënësve. Do ta japim maksimumin që ky proces mos ta dëmtoj fillimin mësimor.

**Avni Bytyqi** - në asnjë formë nuk pretendojmë me iu përzier mësimdhënësve te çështja e zgjedhjes së shtëpisë botuese por dallimi i shtëpive botuese pak te prindërit shkakton telashe. A mund të bisedoni me ta apo është zgjedhja e tyre.

**Remzi Bajselamni** - ky proces është i kryer në qershor dhe prindërit kanë me qenë pak a shumë të orientur për tekstet që janë përzgjedh më herët prej mësimdhënësve.

**Kryetari** - Drejtor, si është gjendja e numrit të nxënësve?

**Remzi Bajselamni** - në vitin e kaluar kemi pas 8.788 nxënës dhe përafërsisht do të jetë ky numër sipas statistikave që kemi por megjithatë e kemi gjendjen stabile sepse vitin e kaluar e kemi kry një proces të mbylljes së disa paraleleve. Kemi një vështirësi në gjimnaz ku kemi një numër të vogël të nxënësve të regjistruar për shkak të kriterëve që i ka gjimnazi.

**Avni Bytyqi** - vazhdimisht komuna është kujdes që të ketë siguri dhe jo vetëm nëpër shkolla por edhe për rreth shkollave dhe ju e dini që në të kaluarën kemi marrë vendime si pasojë që kanë dal rekomandimet nga KKSJ-ja .

**Rekomndim:** kur do herë shkollat dhe DKA të ketë nevojë për mbështetjen e komunës dhe mbështetjen e policisë për çështjen e sigurisë nëpër shkolla dhe për rreth shkollave, ne si komunë jemi të gatshëm dhe do ti zbatojmë kërkesat dhe interesat e gjithë nxënësve dhe shkollave që vijnë.

**Kryetari** - e hedh në votim rekomandimin.

### Aprovohet rekomandimi

### Pika 3. Informatë dhe analizë nga policia e Suharekës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme;

**Kryetari** - përshëndet të pranishmit. I njofton me pikën dhe ia jep fjalën zëdhënës komandantit të policisë.

**Bashkim Gashi** - përshëndet të pranishmit. Sa i përket sigurisë në komunën e Suharekës, kjo siguri është në norma të pranueshme, bëhet me ndihmën e qytetarëve të komunës së Suharekës dhe institucioneve të kësaj komune. Këtë vit ka evolu pak më tepër numri i vjedhjeve por e mira e kësaj është që kemi vjedhje të rëmda shumë më pak por në sezonin verorë kemi rritje të aksidentëve. Policia e stacionit në Suharekë është duke i marrë të gjitha masat e rëndësishme, preventive dhe reaguese.

**Habibe Bytyqi** - ne si mekanizëm kundër dhunës në familjet në qershor e kemi pas takimin e dytë dhe kemi analizu rastet e dhunës në familjet në 6 mujorin e parë. Dua ta pyes zëdhënës komandantin, si qëndron çështja e rasteve të dhunës në familjet, konkretisht në këto dy muaj kur ka qenë edhe numri më i madh i popullsisë ku ka pas edhe ahengje të ndryshme?

**Bashkim Gashi** - kemi rënie ose zbutje të koeficientit edhe pse çështja e dhunës në familje nuk mund të konsiderohet dukuri, është fenomen. Prej mekanizmit ku edhe ju jeni anëtare, duhet me kriju edhe instrumente tjera juridike dhe me ndiku në eliminimin e kauzës. Ndoshta duhet të krijojmë në të ardhmen trajnime, edukime, kurse dhe t'ua mundësojmë nga një profesion të shpejtë, çoftë rrobaqepësi, frizere dhe unë mendoj që angazhimi në punë harxhon energji dhe nuk ka kohë partneri ndaj partnerit për arsye banale të prodhoj dhunë në familje.

**Kryetari** - ne e kemi një bashkëpunim shumë të mirë me policinë. Ne disa gjëra i bëjmë edhe jashtë kompetencave tona si Komunë për me pas një bashkëpunim më të mirë. Çdo herë pas orës 4 makinat e komunës janë në shërbim të policisë dhe këta e kanë obligim ti regjistrojnë kilometrat.

Policia nuk i jep llogari Kryetarit të komunës ose Komunës.

Dhuna në familje është gjithkund. Përdorimi i lëndëve narkotike është në rritje të madhe në gjithë territorin e Kosovës dhe duhet të punojmë më shumë sepse kjo është shumë e rëndësishme.

**Habibe Bytyqi** - sa i përket obligimeve që i ka komuna, Kryetar unë të falënderoj për vullnetin dhe mundësitë që na ke dhënë, konkretisht te rastet e dhunës në familjet. Të gjitha rekomandimet që kanë dalë prej mekanizmit kundër dhunës në familje ke qenë i gatshëm me na i realizua, çoftë fondin e ngritur për policinë dhe QPS-në në rastin e trajtimit të dhunës në familje, çoftë rritjen subvencionimit të strehimores, bonus banimi etj. E kemi diskutuar dhe analizuar në këtë mekanizëm se pothuaj 30% të rasteve të dhunës në familje na i shkaktojnë përdorimi i lëndëve narkotike dhe po ashtu që dhunuesit janë me probleme mendore që ne si komunë e kemi problem me i trajtu këto raste sepse nuk është në kompetencën tonë.

**Rekomandim:** Të vazhdoj bashkëpunimi në mes qytetarëve dhe policisë dhe pse jo dhe komunës me qëllim të eliminimit të këtyre dukurive negative, vjedhjeve.

**Kryetari** - e heh në votim rekomandimin.

### Aprovohet rekomandimi

#### **Pika 4. KKSB-ja t'i ofroj bashkëpunim dhe ta mbështes Këshillin e shkollave dhe nxënësve për të vepruar të organizuar për parandalimin dhe eliminimin e dukurive negative;**

**Remzi Bajselmani** - në secilën shkollë të komunës tonë është i formuar një këshill për siguri që përbëhet prej 5 anëtarëve. Njëri prej anëtarëve është psikologu i shkollës, është anëtari i këshillit të prindërve, anëtari i këshillit të nxënësve, një mësimdhënës që ka autoritet dhe përvojë në shkollë dhe drejtori. Për çdo aksident ose nevojë të veçantë merret këshilli i shkollës dhe nëse është nevoja përcillet në DKA.

**Habibe Bytyqi** - mendoj që të mbetet si rekomandim që ky bashkëpunim të forcohet me një takim që mund të organizohet me anëtarët e KKSB-së dhe kryetarët e këtyre këshillave dhe që bashkërisht do të japin ide më shumë se cila do të jetë forma e bashkëpunimit mes këtyre këshillave dhe KKSB-së.

**Kryetari** - në mandatin e dytë kam propozuar me formu një komision prej të gjitha partive politike dhe me i zgjedh kryetarët e fshatrave dhe edhe ata me pas një mëditje sikurse KKSB-ja për ata që janë jashtë komunës. Ne e kemi obligim 6 herë brenda vitit ti thërrasim në mbledhje. I kemi thirr për sot që ti japin propozimet për buxhet dhe prej 42 fshatrave po vijnë vetëm 11. Kjo mua më befason.

**Adem Dërguti** - te fshatrat që përmende aktivitetin e tyre, sipas mendimit tim ato veq në letër ekzistojnë. Unë kur e kam bërë librin për Tivarin kam kërku prej 42 fshatrave të mbajnë mbledhje sepse e dine sa kanë vuajt ata njerëz. Asnjë fshat nuk ka mbajte takime. Unë i kam gjet në komunë të Suharekë 130 që janë vra dhe 450 që kanë shpëtu. Vetëm Temeqina si fshat i ka thirr familjarët e Tivarit.

**Avni Bytyqi** - edhe unë e pata idenë sikurse propozimi i Habibes dhe pajtohem që Drejtori i Arsimit ti thërras kryetarët e këshillave të gjitha shkollave dhe të mbajnë një takim të shpejt. Unë jam i gatshëm dhe i përgjigjem kërkesës së DKA-së që ta mbajnë takimin dhe KKSB-ja ti merr të gjitha shqetësimet, problemet që i kanë këshilli shkollave.

**Remzi Bajselmani** - ne jemi të shqetësuar me publikimet dhe deklaratimet e njerëzve publik nëpër portalet e ndryshme gjë që e kanë dëmtua pak procesin.